

1. Sa pika grumbullimi për produktet bujqësore (fruta, vaj ulliri, etj.) ka në Bashkinë e Elbasanit?

Në qarkun e Elbasanit funksionojnë 8 pika grumbullimi (4 pika grumbullimi bimë medicinale, 4 pika grumbullimi fruta-perime). Konkretisht:

- Bashkia Elbasan, 1 pikë grumbullimi në Njësinë Administrative Shushicë e cila grumbullon bimë medicinale.
- Bashkia Cërrik, 3 pika grumbullimi në fshatrat Lumas dhe Banjë, në Njësinë Administrative Klos, fshati Kamuna dhe në Njësinë Administrative Mollas të cilat grumbullojnë perime të serës nga fermerë të zonës.
- Bashkia Peqin, 1 pikë grumbullimi në fshatin Bishqem në Njësinë Administrative Pajovë, e cila grumbullon kryesisht agrume dhe fruta nga fermerë të zonës.
- Bashkia Përrenjas 1 pikë grumbullimi e cila grumbullon bimë medicinale të fermerëve të zonës.
- Bashkia Gramsh 2 pika grumbullimi e cila grumbullon bimë medicinale të fermerëve të zonës.

2. Si është menduar krijimi i pikave të grumbullimit për Bradasheshin, Gjergjan dhe Shushicë?

3. Kur do të krijohen këto pika? Cili është afati? Në cilën adresë është menduar të ndërtohen këto pika?

4. Cilave zona (fshatrat/njësi administrative) do t'u shërbejnë këto pika?

5. Sa do të kushtojë investimi?

Për pyetjet 2, 3, 4 dhe 5: Pikat e Grumbullimit janë investime private. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, me anë të "Skemës Kombëtare" ka parashikuar masë mbështetëse për ndërtimin e tregjeve të produkteve bujqësore dhe blegtorale, me kërkesë nga Bashkia përkatëse.

Për vitin 2022, në qarkun e Elbasanit është mbështetur ndërtimi i tregut të bashkisë Belsh, ndërsa për vitin 2023 është parashikuar mbështetja e tregut të bashkisë Peqin, investime të cilat do të shërbejnë si një pikë e rëndësishme takimi midis fermerëve, shoqërive tregtare, duke luajtur një rol të rëndësishëm në promovimin e produkteve si dhe përmirësimin e ekonomisë rurale në zonat përkatëse.

6. Në cilën fazë janë punimet për pastrimin dhe sistemimin e përroit/gurrës së Shushicës?

7. Në çfarë konsiston, teknikisht, procedura e pastrimit dhe sistemimit?

8. Cilat janë afatet e përfundimit?

9. Sa është vlera e investimit?

10. Sa sipërfaqe do të përfshihet në pastrim dhe sistemim? Në cilat zona?

Për pyetjet 6-10 duhet t'i drejtoheni Bashkisë Elbasan.